



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 1684/prot
1

Tiranë, më 31/08/2022

URDHËR

Nr. 222/4 datë 31.08.2022

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.182, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN KRITEREVE, PROCEDURAVE E DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, SI DHE NDIHMËSIT PERSONAL", TË NDRYSHUAR,

Bazuar në ligjin nr.57, datë 18.07.2019, "Për Asistencën Sociale në RSH", pikat 1 dhe 6 të kreut III, të VKM nr.182, datë 26.02.2020, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimi të pagesës për personat me aftësi të kufizuar, si dhe ndihmësit personal", të ndryshuar, si dhe VKM nr. 135, datë 07.03.2018 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror", i ndryshuar,

URDHËROJ:


- 1.Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar ,të përcaktuar në pikën 1, të kreut III, të VKM nr.182, datë 26.02.2020 , bëhet 11.915 (njëmbëdhjetëmijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) lekë në muaj.
- 2.Të njëjtën masë pagese përfiton edhe ndihmësi personal i personit me aftësi të kufizuar, i përcaktuar në shkronjën " b", të nenit 8, të ligjit nr.57/2019.
- 3.Pagesa e ndihmësit personal të personit me aftësi të kufizuar të përcaktuar në shkronjën " a", të nenit 8 të ligjit 57/2019 bëhet 12.515 (dymbëdhjetëmijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë në muaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 01.09.2022.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reme Xholi

Konceptoi: H. Rapa
Miratoi: G. Minxha
Kopje: 16
Data: 31.08.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 1684/2 prot

Tiranë, më 31/08 2022

URDHËR

Nr. 221/2, datë 31.08.2022

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.277, DATË 18.06.1997, "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT", I NDRYSHUAR.

Bazuar në ligjin nr.8098, datë 28.03.1996, "Për Statusin e të Verbërit", i ndryshuar, të pikës 4, të VKM nr.277, datë 18.06.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", i ndryshuar si dhe VKM nr. 135, datë 07.03.2018 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.06.1997, i ndryshuar, bëhet 13.525 (trembëdhjetëmijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë në muaj.


Të njëjtën masë pagese përfiton edhe kujdestari i të verbërit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 01.09.2022.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reme Xholi

Konceptoi: H. Rapa
Miratoi: G. Minxha
Kopje: 16
Data: 31.08.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 1684/3 prot

Tiranë, më 31/08/2022

URDHËR

Nr. 22/3 datë 31.08.2022

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.31, DATË 20.01.2001, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIKË DHE
TETRAPLEGJIKË”, TË NDRYSHUAR,**

Bazuar në ligjin nr.57, datë 18.07.2019, “Për Asistencën Sociale në RSH”, ligjin 8626, datë 22.06.2000, “Statusi i Invalidit Paralegjikë dhe Tetraplegjikë”, i ndryshuar, të VKM nr.31, datë 20.01.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paralegjikë dhe tetraplegjikë”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

- 1.Masa e përfitimit për invalidët paralegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të VKM nr.31, datë 20.01.2001, bëhet 11.915 (njëmbëdhjetëmijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) lekë në muaj.
- 2.Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paralegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të VKM nr.31, datë 20.01.2001, bëhet 12.515 (dymbëdhjetëmijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë në muaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 01.09.2022.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reme Xholi



Konceptoi: H. Rapo
Miratoi: G. Minxha
Kopje: 16
Data: 31.08.2022